



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 4720 Prot

MINISTRI

Tiranë më 13.122022

UDHËZIM

Nr. 670, datë 13/122022

“PËR
PROCEDURËN E APLIKIMIT DHE PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I MBROJTJES
SË VEÇANTË NGA SHTETI, PËR GRATË E PAPUNA, ME TRE APO MË SHUMË
FËMIJË TË MOSHËS DERI NË 18 VJEÇ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 58, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të pikës 3, të Vendimit nr.751, datë 01.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për një mbrojtje të veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”,

UDHËZOJ:

1. Gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 mijë lekë bruto në muaj, të cilat janë kategori ekonomikisht joaktivë, mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor dhe pagesa e kontributeve të tyre financohet nga buxheti i shtetit, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5 vjeçare.
2. Aplikimi dhe verifikimi për përfshirje në programin e veçantë të subvencionit nga shteti për pagesat e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor bëhet në mënyrë elektronike, përmes shërbimit elektronik qeveritar e-Albania.
3. Lista e përfituesve gjenerohet nëpërmjet Regjistrit Kombëtar Elektronik të Ndhmës Ekonomike në nivelin qendror të Shërbimit Social Shtetëror.
4. Lista e përfituesve verifikohet automatikisht brenda datës 25 të çdo muaji për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.

5. Shërbimi Social Shtetëror, brenda datës 20 të çdo muaji pasardhës përgatit listëpagesën me kontributet shoqërore dhe shëndetësore të personave që rezultojnë përfitues, ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe kryen pagesën sipas legjislacionit në fuqi.

6. Shërbimi Social Shtetëror të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe Agjensinë Kombëtare të Shkëmbimit të Informacionit për procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 01.01.2023.

Ogerta MANASTIRLIU

